

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË MINAMATËS “PËR MËRKURIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është të finalizojë procesin e ratifikimit të konventës së Minamatës “Për mërkurin”, detyrim ky që rrjedh në zbatim të legjislacionit për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Konventa e Minamatës është miratuar, në parim, nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet vendimit nr.663, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, dhe vetë konventa ka hyrë në fuqi me 16 gusht 2017.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektligji është hartuar në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, ku përcaktohet objektivi për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe garantohe mbrojtja e mjedisit.

Ky projektligj është i parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2019, katërmujori III, si dhe vjen edhe në kuadër të detyrimeve kombëtare, ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për mërkurin.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mërkuri është një substancë shumë toksike e cila, nëse shkarkohet në ajër, tokë dhe ujë, mund të shkaktojë rreziqe serioze për njerëzit, peshqit, ekosistemet dhe kafshët e egra. Mërkuri mund të udhëtojë në distanca të largëta përmes ajrit dhe ujit, dhe si i tillë përfaqëson një kërcënim global që mund të trajtohet nëpërmjet një bashkëpunimi të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim, ky projektakt përbën një kuadër rregullator me qëllim mbrojtjen

e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit në vend nga efektet e dëmshme të mërkurit, si dhe kontribuon edhe në kufizimin e kontrollin e shkarkimeve të mërkurit në nivel global.

Në vendin tonë i vetmi problem me mërkurin konsiston në mbylljen e fabrikës së sodës kaustike (PVC) në Vlorë në vitin 1992, zonë e cila nuk u trajtua në atë kohë për mbetjet e rrezikshme të mërkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës. Si rrjedhojë, kjo zonë ka qenë në qendër të vëmendjes të disa projekteve studimore për vite me radhë. Studimet e para për këtë zonë i përkasin vitit 2002, kur u identifikua si një *hot-spot*, për të vijuar më tej në 2004, 2008, 2012 dhe së fundi në 2016.

Në vitin 2012, në kuadër të një studimi të qendrës mjedisore EDEN, në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve të Biodiversitetit (BRI) dhe peshkatarët vendas u morrën mostra specifike në:

- a) peshq merluc (11 mostra) dhe barbun (3 mostra). Analizat e kryera mbi nivelin e mërkurit, në laboratorin në Gorham, Maine, SHBA, treguan se vlerat maksimale të mërkurit të vëzhguar në barbun ishin më shumë se katër herë më të larta se doza referuese. Dy nga mostrat e barbuneve gjithashtu tejkaluan kufirin e BE-së;
- b) 15 mostra flokësh në banorë, në brendësi të ish-uzinës së PVC-së. 3 kampione nga 15 mostrat e marra rezultuan me norma me të larta se masa referenciale.

Në vitin 2016, qendra EDEN në kuadër të një studimi ndërkombëtar për monitorimin e mërkurit, mori kampione flokësh në 30 femra të moshës 18-44 vjeç. Rezultatet treguan se 7 nga këto gra kishin nivele të larta të mërkurit dhe më tepër se 7 të tjera tregonin nivele më të larta se gjysma e nivelit të vendosur si limit në masën referenciale. Referuar raportit më të fundit studimor për këtë zonë (Raporti tregues për situatën mjedisore dhe shëndetësore në zonën e ish- Uzinës së PVC-së, i dy qendrave mjedisore CRCDD dhe EDEN, maj 2018), kjo zonë sot është strehë e rreth 100 familjeve.

Konventa e Minamatës është miratuar, në parim, me vendimin nr.663, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave. Pas nënshkrimit të konventës, vendi ynë përfitoi nga instrumentet financiare të Fondit Global për Mjedisin (GEF), për zbatimin e kërkesave të saj.

Me mbështetjen financiare të GEF, gjatë periudhës 2016 - janar 2019, ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me UNDP, zbatuan në vend projektin “Vlerësimi fillestar i Minamatës”, i cili synoi përshtetjen e përgatitjeve të

Shqipërisë për ratifikimin e konventës së Minamatës dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Gjatë zbatimit të projektit “Vlerësimi fillestar i Minamatës në Shqipëri” janë organizuar disa aktivitete, takime në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve kryesore të linjës, përgjegjëse për adresimin e çështjes së Mërkurit në vend. Ekspertiza teknike, e brendshme dhe e huaj, e ofruar në këto takime, ndër të tjera, ka kontribuar edhe në ngritjen e kapaciteteve teknike të administratës shtetërore në drejtim të çështjes së mërkurit.

Gjithashtu, në kuadër të projektit:

1. Është rishikuar kuadri ligjor i politikave dhe ai rregullues me qëllim përcaktimin e kërkesave për zbatimin e konventës. Në këtë kuadër, janë analizuar të gjitha aktet ligjore që lidhen me prodhimin dhe përdorimin e mërkurit në të gjithë sektorët; është përgatitur raporti mbi analizën e boshllëqeve legjislative.
2. Është realizuar vlerësimi kapaciteteve institucionale për zbatimin e konventës së Minamatës. Raporti “Vlerësimi i legjislacionit ekzistues shqiptar dhe identifikimi i mangësive lidhur me zbatimin e konventës së Minamatës”, në 2 (dy) gjuhë shqip dhe anglisht.

http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/environment_energy/assessment-of-the-legislation-and-of-the-capacities-of-main-inst.html

3. Është hartuar plani i komunikimit me aktorë të interesuar. Në kuadër të projektit, është hartuar Plan i Komunikimit, Edukimit dhe Ndërgjegjësimit të Publikut (CEPAF), i cili synon të identifikojë se si këto aktivitete mund të plotësohen dhe të rrisin komunikimin me publikun e gjerë dhe partnerët, të rrisin ndërgjegjësimin për çështjet që lidhen me konventën e Minamatës dhe ratifikimin e saj në të ardhmen duke sinkronizuar veprimet e përbashkëta në aktivitetet arsimore e ndërgjegjëse dhe krijimin e sinergjisë për të siguruar vlerën e shtuar, duke shmangur dublikimin e përpjekjeve brenda palëve kryesore të interesit.
4. Është përgatitur për herë të parë Inventari Kombëtar i Mërkurit, i cili identifikon burimet e gjenerimit të mërkurit, së bashku me aktivitetet dhe sasi të tyre; sektorët që përdorin mërkurin e sasi të përkatëse si dhe burimet e shkarkimeve të mërkurit, të cilat janë pjesë e Inventarit të Mërkurit në Shqipëri. Inventari Kombëtar i Mërkurit, ndër të tjera, ndihmon edhe për adresimin e shkarkimeve të mërkurit në vend.

5. Është përgatitur Plani Kombëtar i Veprimit dhe masat prioritare të mërkurit. Një ndër rekomandimet e këtij dokumenti është edhe miratimi nga Kuvendi i ligjit për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin”.
6. Është hartuar e miratuar vendimi nr.442, datë 26.6.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të mërkurit metalik, komponimeve dhe disa përzierjeve të mërkurit, për ruajtjen e sigurt të mërkurit metalik, si dhe kriterëve specifike për ruajtjen e mërkurit metalik të konsideruar si mbetje”.

Sa më sipër, si dhe duke vlerësuar zhvillimet e bëra gjatë kësaj periudhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit gjykoi si të arsyeshme vijimin e procesit të ratifikimit të konventës së Minamatës “Për mërkurin”. Aktualisht, konventa e Minamatës “Për mërkurin”, është firmosur nga 128 shtete dhe ratifikuar nga 105 shtete (<https://sdg.iisd.org/neës/minamata-convention-reaches-105-ratifications/>).

Procesi i ratifikimit të kësaj konvente nga Republika e Shqipërisë ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga çlirimet dhe shkarkimet antropogjenike të mërkurit dhe do të finalizojë procesin e adresimit të:

- problemeve që shkakton në mjedis dhe në atmosferë lëshimi i pakontrolluar i mbetjeve teknologjike që përmbajnë mërkur;
- kontrollit dhe marrjes së masave për reduktimin e mërkurit në produkte, procese dhe në industrinë që përdorin, çlirojnë ose shkarkojnë mërkur;
- hartimit të legjislacionit dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit nga mërkuri dhe përbërjet e tij;
- bashkëpunimit ndërinstitucional dhe midis sektorëve të ndryshëm për evidentimin e zonave të mundshme të ndotura me mërkur, produkteve dhe proceseve që përfshijnë mërkurin, alternativat e mundshme për mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit nga mërkuri, rehabilitimin e tyre, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për këto rreze.

Ratifikimi i konventës “Për mërkurin” do të shoqërohet me kosto dhe përfitime për zbatimin e kërkesave të saj.

Bërja palë në konventën e Minamatës “Për mërkurin”, gjithashtu, krijon përfitime të caktuara. Për vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion përfitimet do të jenë në aspektin e ndihmës teknike dhe financiare.

Gjithashtu, cilësia e shtetit palë në këtë Konventë sjell një numër përfitimesh në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, sikundër mërkuri është një çështje globale që kërkon veprim të bashkërenduar në nivel ndërkombëtar për mbrojtjen

efektive të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Përparësitë kryesore të ratifikimit të konventës së Minamatës “Për mërkurin”, lidhen me faktin se i lejon secilit shtet anëtar palë:

1. të mbrojnë shëndetin dhe mjedisin e popullit të vet duke përfituar nga përpjekjet globale për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga emetimet antropogjene dhe shkarkimet e mërkurit në mjedis e përbërjet e tij;
2. të sigurojnë mbrojtjen nga import/eksportet e padëshiruara të mërkurit dhe produktet e tij;
3. të kontribuojë në angazhimin e konventës ndaj objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
4. të mundësojnë ngritjen e kapaciteteve, asistencën teknike dhe transferimin e teknologjive. Mekanizmi financiar i krijuar në kuadër të konventës synon të sigurojë burime financiare të përshtatshme, të parashikueshme dhe në kohë për të mbështetur palët e vendeve në zhvillim dhe palët e vendeve me ekonomi në tranzicion në zbatimin e detyrimeve që kanë ndaj konventës. Neni 14 i konventës specifikon dispozitat që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, asistencën teknike dhe transferimin e teknologjive për këto vende anëtare;
5. të lehtësojnë partneritetin dhe bashkëpunimin për të mbështetur zbatimin e detyrimeve të caktuara, për shembull për çështjen e mbetjeve të mërkurit, magazinimit të përkohshëm, vendeve të kontaminuara ose minierave artizanale dhe të vogla të arit;
6. të përmirësojnë qasjen në teknologji, të dhëna dhe informacione të dobishme, veçanërisht nëpërmjet shkëmbimit të rregullt të informacionit dhe ekspertizës;
7. të përmirësojnë informacionin, rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik;
8. të përmirësojnë kërkimin dhe zhvillimin, duke përfshirë edhe alternativat pa-mërkur.

Palët ndikojnë në zhvillimin e zbatimin e konventës përmes pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes së Konferencës së Palëve (COP).

Përveç përfitimeve, çdo shtet, përfshirë edhe Republikën e Shqipërisë, duhet të marrë në konsideratë edhe rreziqet e mundshme të mosbërjes palë, duke përfshirë analizën se si mund të ndikojë zbatimi i konventës në shtetet jo palë, lidhur me: p.sh. kufizimet në tregtinë e mërkurit, si dhe risqet se shtete të tilla jo palë mund të përballen me "vendgrumbullime/dumping" të padëshiruara të mërkurit ose produkte me mërkur të shtuar brenda territoreve të tyre.

Si përfundim, duke u bërë palë në konventën e Minamatës “Për mërkurin”, shtetet anëtare mund të përfitojnë nga fondet në kuadër të programit të veçantë

për të mbështetur forcimin institucional në nivel kombëtar për të rritur zbatimin e konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit, Konventës së Minamatës dhe Qasjes Strategjike për Menaxhimin Ndërkombëtar të Kimikateve (SAICM).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe hartohet në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës si dhe të kërkesave të ligjit nr.43/2016, Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 17 të të cilit përcaktohet procedura e ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të nënshkruar më parë nga Republika e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron asnjë direktivë/rregullore të Bashkimit Evropian, por vjen në kuadër të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që vendi ynë ka në lidhje me adresimin e problematikave për merkurin.

Vendimi nr.442, datë 26.6.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe kriteret specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje”, transponon pjesërisht rregulloren (EU) 2017/852 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 17 maj 2017, mbi merkurin, e cila shfuqizon rregulloren (EC) nr.1102/2008, *OJ L 137, 24.5.2017, fq. 1–21*.

Duke qenë se kërkesat e rregullores së BE-së nr.2017/852 janë në përputhje me ato të Konventës së Minamatës “Për merkurin”, për rrjedhojë edhe vendimi nr.442, datë 26.6.2019, i Këshillit të Ministrave, që transponon rregulloren (EU) 2017/852, përbën referencën ligjore teknike që do të vërë në zbatim Konventën e Minamatës në Republikën e Shqipërisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji ka 2 nene. Struktura e tij është si më poshtë:

Neni 1: Republika e Shqipërisë ratifikon konventën e Minamatës “Për merkurin”

Neni 2: Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me strukturat në varësi të saj, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për ndjekien e monitorimit të procesit, agjencitë rajonale të mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror përgjegjës për mjedisin; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë organet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në paragrafin 6 (b), konventa thekson se kontributi financiar i vendeve anëtare do të jetë vullnetar. Ratifikimi i konventës së Minamatës “Për merkurin” do shoqërohet me kostot për zbatimin e kërkesave të konventës që përfshijnë ndër të tjera edhe:

- hartimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar, me masat që do të ndërmerren për kontrollin e çlirimeve;
- ngritjen dhe mirëmbajtjen e inventarit të emisioneve nga burimet përkatëse dhe raportimin vjetor te Sekretariati i Konventës;
- inventarin fizik të merkurit, nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- sistemin GIS për të krijuar hartën e zonave të ndjeshme të merkurit në nivel kombëtar;
- përdorimin dhe instalimin e teknologjive më të mira në dispozicion (BAT), në impiantet e reja industriale dhe marrjen e masave për mosshkarkimin e merkurit gjatë proceseve në minierat e bakrit.

Bërja palë në konventën e Minamatës “Për merkurin”, gjithashtu, krijon përfitime të caktuara. Për vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicion, përfitimet do të jenë në aspektin e ndihmës teknike e financiare.

Palët e konventës së Minamatës janë të detyruara t'i përmbahen detyrimeve të saj.

1. Bazuar në nenin 13 të konventës secila palë duhet të sigurojë, brenda mundësive të saj, burimet në lidhje me ato aktivitete kombëtare që synojnë zbatimin e konventës, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar politikat, prioritetet, planet dhe programet. Ky nen, gjithashtu, përcakton një mekanizëm financiar për të mbështetur palët dhe vendet në zhvillim dhe ato me ekonomi në tranzicion në zbatimin e detyrimeve të tyre.

2. Palët kanë detyrime financiare për të mbështetur funksionimin e konventës, Konferencën e saj të Palëve (COP) dhe sekretariatit e ratifikimit, palët duhet të derdhin kontributet e tyre vjetore në Fondin e Përgjithshëm të Besimit (*General trust fund*), të krijuar në kuadër të konventës. Derdhja e këtij kontributi nga secili shtet anëtar ndihmon në zbatimin e programit të miratuar të punës për këtë konventë.

Në rastin e Shqipërisë, bazuar në eksperiencën e deritanishme me konventa të tjera të ngjashme në fushën e kimikateve dhe mbetjeve të tyre (Stockholm, Rotterdam, Basel), kontributet vjetore të këtij lloji për vendin tonë vlerësohen nga 400 deri në 800 dollarë/vit (maksimumi).

Ashtu sikur është theksuar më lart, cilësia e të qenit palë në këtë konventë do t'i mundësojë stafeve teknike të MTM-së, por edhe të institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me adresimin e çështjes së mërkurit, që të marrin pjesë në workshope, trajnime apo aktivitete të tjera ndërkombëtare, të cilat do t'i ndihmojnë ato në punën e tyre të përditshme për hartimin/zbatimin e politikave lidhur me këtë fushë apo adresimin e një sërë problemesh kombëtare apo rajonale që kanë të bëjnë me çështjen e mërkurit, produkteve ose zonave të ndotura që përmbajnë mërkur.

Anëtarësimi në këtë konventë pritet ta ndihmojë vendin tonë edhe nëpërmjet përfitimit të fondeve për zbatimin e projekteve të ndryshme në këtë fushë, me fokus mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit në vend nga efektet e dëmshme të mërkurit, si dhe kufizimin e kontrollit të shkarkimeve të mërkurit në nivel global. Një informacion i hollësishëm lidhur me konventën, strukturat e organizmat e saj, takimet e palëve (COP), aktivitetet që janë zhvilluar e do të zhvillohen etj. pasqyrohen nëpërmjet linkut të kësaj konvente – <http://www.mercuryconvention.org/>.

Për sa më sipër, mund të themi se përfitimet e vendit tonë që priten pas ratifikimit të konventës së Minamatës do të jenë shumë herë më të mëdha se vlera modeste e *kontributit vjetor*, që vendi ynë do të duhet të paguajë si pjesë e të qenit palë në konventë.

KËSHILLI I MINISTRAVE